BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

SHPALLJE PËR PRAKTIKANTË

Titulli: Praktikantë, tetë (8) pozita

Departamenti: i Statistikës

Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit të Statistikave të Jashtme

Në kuadër të programit "Praktika profesionale me studentë" Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall konkurs për pranimin e tetë (8) praktikantëve, me kohë të caktuar për një muaj. Objektivi kryesor i këtij programi është që stafi profesional i BQK-së të ndaj përvojat me studentët të cilët do të kryejnë këtë praktikë. Programi i praktikës për studentë u mundëson lidhjen midis njohurive të fituara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionet publike të pavarura. Ky program zgjatë katër javë dhe nuk nënkupton në asnjë mënyrë marrëdhënie formale pune me BQK-në.

Studentët do të angazhohen drejtpërdrejt në realizimin e një projekti studimor për të vlerësuar nivelin dhe strukturën e shpenzimeve të diasporës kosovare gjatë qëndrimit në Kosovë. Projekti mbikëqyret nga Departamenti i Statistikës në BQK. Si pjesë e projektit, studentët do të zhvillojnë anketa në terren në disa pika të përzgjedhura kufitare të Kosovës gjatë periudhës së verës 2026.

Njohuritë e kërkuara:

- Kandidatët duhet të jenë studentë në studime universitare ose në studime pasuniversitare, në fushën e ekonomisë, statistikës, matematikës ose drejtime të ngjashme;
- Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës ekipore;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë njohuri të mira në zbatimin e teknikave moderne statistikore, grumbullim të të dhënave dhe hulumtime statistikore;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë njohuri të mira në aplikimin e softuerëve statistikor, si: STATA, SPSS dhe softuerë të tjerë relevant.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim për "Programi i praktikës për studentë";
- CV të detajuar;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për praktikë në BQK;
- Lista e notave nga universiteti përkatës;
- Një letër referencë;
- Kopja e letërnjoftimit apo ndonjë dokumenti tjetër identifikues;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është deri më **29 qershor 2026.**
- Aplikimi mund të bëhet në e-mail adresën praktika@bqk-kos.org. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formulari i aplikacionit mund të shkarkohet përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.